



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 40 dt.08.05.1995

Këshillit Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.08.05.1995, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur për shqyrtim nga Seksioni i Prognozës “Për rritjen e pagave të këshillit drejtues të Ndërmarrjes Artistike “Migjeni”, në zbatim të V.K.Ministrave Nr.463, dt.03.10.1994, dhe të udhëzimit Nr.2185, dt.12.12.1994, të Drejtorisë së Pagave dhe Mardhënieve të Punësimit të Ministrisë Industrisë dhe të Tregëtisë, dhe në zbatim të kopetencave që Këshilli Bashkiak i jep ligji “Për ndërmarrjet shtetërore” Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.5 dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10

**VENDOSI**

1. Pagën :

- Për drejtorin e Ndërmarrjes Artistike “Migjeni” 7.000 lekë në muaj.
- Për anëtarët e K.Drejtues, paga mujore të jetë 12 – 20 % më e vogël se paga e drejtorit.
- Drejtori dhe Këshilli Drejtues përfitojnë rritje mbi pagë mbi 5 – 70%, në të njëjtën masë do të përfitojnë

dhe punonjësit e tjerë të ndërmarrjes, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në dispozitat ligjore.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**